

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sokol Sinani-Sekretar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Z. Sokol Sinani bën apelin, prezent në sallë janë 42 antarë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës

2. Miratimi I proçesverbalit Datë 30.04.2025

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Prill 2025

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3.1 e rendit të ditës

3.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Prill 2025

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Procesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4. Për miratimin e dhënies me qera të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani” në lagjen 28 Nëntori nga Bashkia Elbasan

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(A. Kana; E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 5 e rendit të ditës

5. Marrje me qera (rinovim kontrate) ambjent që do të përdoret si strehëz për qentë endacakë

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Është e disata herë që diskutojmë për pikën e trajtimit të qenve endacakë. Jam koshiente që sot thuhet fjalë për qeramarrjen dhe rinovimin e kontratës qeramarrjes së ambjenteve ku do të strehoen por vazhdoj ti mëshoj pikës që gjithsecili nga ne që jeton në Elbasan e shikon si emergjencë qytetare faktin që rrugët janë mbushur me qen endacakë. Nuk janë të pakta edhe rastet e agresioneve, dhe jo më larg sesa mbrëmë rreth rrotullimit të Bradasheshit kam parë me sytë e mi sesi një furgon që erdhi nga Tirana shkarkoi një tufë qensh, totalisht të paorientuar që vinin vërdallë dhe jam e sigurtë që kto qen nuk kanë asnjë lloj trajtimi apo te pavaksinuar nga ana e shërbimeve tona që ofron Bashkia. Kështu që persa kohë kjo qendër ekziston, unë do doja të dija cilat janë masat shitesë që po merren në dobi të qytetit, të qytetarëve për trajtimin e këtyre kafshëve dhe për izolimin e tyre? Jam koshiente edhe për ekzistencën e shoqatave animaliste por ne nuk mund të vëmë interesin e kafshëve përpara interesit të njerëzve. Unë konkretisht kam vështirësi kur hyj në shtëpi në darkë mbas orës 08:00 e pashoqëruar ose pa patur në dorë ndonjë gur ose shkop për të përzënë qentë që rrijnë në lagjen time, dhe nuk e kam lagjen shumë larg në periferi por e kam në mes të qytetit. Sa është kapaciteti. Sa është rritur kapaciteti i trajtimit të këtyre qenve? Mesa mbaj mend vjet ka qen rreth 60 qen që trajtohen atje dhe trajtimi ditë ambulator që i bëni rreth sterilizimit apo vaksinimit. Duam

informacion të saktë mbi këtë, duke patur parasysh edhe faktin kur I sterilizoni apo I vaksinoni nuk I shkulni dhëmbët. Ju lutem këtë problematikë ta merrni me prioritet. Nëse duhet që ti caktojmë fonde shtesë nga Këshilli Bashkiak jam shumë dakort që ti gjejmë diku ti marrim në një zë tjetër që ndoshta është më pak I rëndësishëm, bëhet fjalë për sigurin qytetare, për sigurin tonë, për sigurinë e femijve. Mos flasim pastaj për shfaqjen që kemi në sytë e atyre që supozohet të vijnë si turistë në qytetin e Elbasanit, te rrapi I Bezistanit, aty ku zbresin turistët aty janë edhe grumbujt me qen.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Znj. Madhi shqetësimi juaj është I drejtë dhe është për të gjithë. Do doja nga Bashkia që ta ketë në konsideratë këtë shqetësim.

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana; E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6.Mbi dhënien me qera (rinovim kontrate)të ambientit (dhomë farmaci),Nj.A Bradashesh nga Bashkia Elbasan

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Dhënia me qera është me të njëjtën afatkohor

Fatmir Vodollari-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Mund të propozoj diçka sepse shohim këtu që janë ca pika për ambjentet me qera edhe ne në çdo mbledhje kemi dhënie me qera.Nuk është e mundur që këto të bëhen në afatet e ripërtëritjes me afatet e kontratës fillestare?S”është nevoja të bëhet vit për vit,kush e ka patur një herë në 3 vjet të bëhet për 3 vjet ,kush e ka patur për 5 vjet të bëhet për 5 vjet,pse të bëhen të gjitha vit për vit.Ky është propozim.Edhe ajo e qenve e njëjta gjë.

Shpëtim Llapushi-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Hapsira ligjore është me kusht që çmimi të vihet sipas VKB përkatëse

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë sapo citova me të njëjtën afat kohor,siç ka lidhur kontratën e mëparshme,nuk përmenda problemin e tarifës sepse ato pastaj ndryshojnë

Doris Madhi-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Është ligji për prokurime public që përkufizon faktin që kontratat duhet të rinovohen sepse konsiderohen si shitje nga ana e Bashkisë sepse bashkia mer një përfitim në këtë rast prandaj rinovohen çdo vit,ndoshta mund të ndryshojnë edhe

çmimet në bazë të cmimeve të tregut prandaj ndosh kjo, konsiderohet si formë kontratë por duhet bërë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Isha me mendimin që thashë me të njëjtin afat kohor sepse duke menduar që kontrata vjet ka qenë firmosur 1 vjeçare dhe sivjet ose dikush tjetër 2 vjeçare besoj që e njëjta afat..

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalon sipas përcaktimeve të ligjeve nuk është se e vendosim në sesa do zgjasi kontrata. Ligji I prokurimit publikon të detyron të bësh këtë që po bëjmë sot. Është prokurim se po jep me qera, dhënia me qera krijon përfitim, përfitimi është shitja

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kush është pro për propozimin që dha Z. Fatmir Vodollari? Të bëhet në të njëjtin afat kohor që ka patur kontrata që është lidhur vjet apo parvjet, pa cituar që kjo të bëhet 2 apo 3 apo 4 vjeçare

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, 3- abstënim, miraton sa më sipër.

(A. Kana; V. Balliu; E. Muzhaqi)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7.Mbi dhënien me qera (rinovim kontrate) të ambientit (bodrum), lagjia Kongresi Elbasanit nga Bashkia Elbasan

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.Balliu;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8. Mbi dhënien me qera (rinovim kontrate) të objektit Albania Tourism ndodhur në Z.K 8521, nga Bashkia Elbasan

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zonja në fjalë është subject privat? Qeramarrësja te ky objekt është një subject privat që operon për hesap të vet apo është e liçensuar nga Bashkia apo e promovuar nga Bashkia që të bëj këtë punë sepse përse I përket për të promovuar turizmin Elbasan, është biznes privat sepse në këtë që sapo lexova është kur ajo promovon turizmin për qytetin e Elbasanit për të sjellë të ardhura. Nëse është nga Bashkia nuk e kuptoj pse duhet të lëshohet me qera sepse është një ambient që është brenda Bashkisë dhe Bashkia ka detyrim që të bëjë promovimin e turizmit në qytetin tonë. Nuk është se duhet të lëshojë një ambient me qera, ktu çfarë marrdhënie është privat-shtet apo është shtet-shtet?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Private janë të gjitha këto ambiente, siç kanë qenë kontratat

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Normalisht ajo punon edhe për llogari të vet. Është e bazuar në ligj që një privat të mund të marri një ambient me qera dhe të bëj promovimin e Bashkisë, nuk e kuptoj ktu pjesë sepse patëm një ambient të tillë që fatkeqsisht më vonë u kthye në një biznes privat që e kemi përpara turizmit, është e njëjta procedurë që ndiqet, përdoret disa kohë si ambient e dhën me qera për biznes të caktuar për të promovuar turizmin në qytetin e Elbasanit që është gjë e mirë dhe e përgëzohet nga ana e Bashkisë por mos na ndodhi si rasti I mëparshëm I cili është kthyer në një local

dhe e shhim përditë,në vend të ishte një pikë informacioni për dhënien e informimit për turistët është kthyer në një local.Nuk e di kush e ka marrë atë vendim por nuk më duket e udhës.Mos na ndodh po I njëjti fenomen për këtë e ngrita këtë shqetsim.

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, 1- kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana)

(V.Balliu;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9.Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Rivitalizim Urban I shesheve të pallateve nr 588,712 etj në lagjen 5 Maj, Z.K 8525 nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Ky është një ndërtim para apo pas viteve 90 dhe sa është shuma për metër katror që I ofrohet ?

Marvis Avllazagaj-Përfaqësues I Administratës

Referuar korrespondencës së bër me ASHK janë ndërtime mbas viteve 90, shtesa pallati në katin përdhe dhe që janë tipi I parë I këtyre ndërtesave që kërkohen të hiqen dhe pjesa tjetër janë dy prona të cilat janë sheshe aktualisht por që janë prona private, sheshe që ndodhen në mes të bllokut të banimit. Këto do kthehen në sipërfaqe publike me akses kryesisht rrugë, sheshe publike dhe parkime për zonën e banimit në të cilën ndodhen. Jemi koshient që shtesat e pallateve në katin përdhe janë të gjitha sabotuse të sipërfaqeve publike

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Zotëri po ju drejtohem ju, ato të cilat do të shpronësohen janë vetëm sheshe para pallateve të cilat rezultojnë si prona, si tokë në pronësi të privatit janë banesa? Po banesa a ka banesa? Banesa private, oborre të banesave private të cilat janë të rrethuara .

Marvis Avllazagaj-Përfaqësues I Administratës

Po banesa janë kryesisht. Banesa nuk ka por janë kto oborret e banesave private të cilat janë pa ndërtim , janë të gjitha ndërtesa pas viteve 90.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Mund të sqaroj diçka? Rruga Xhaferr belegu është rruga paralel me kolaudimin. Aty është një zonë që është informale totalisht, të gjithë jemi koshient, është rruga paralele me Manazderen pra është bër në krahun e kolaudimit dhe do vazhdojë me krahun tjetër që është një projekt I cili vjen në shërbim dhe në dobi të shtresave kryesisht të marxhenalizuara por edhe atyre që janë në komunitetin rom dhe egjiptiane. Është një projekt I tillë që I vjen në ndihmë ktyre komuniteteve për të përmirësuar cilësinë e jetesës së tyre. Ka prishje të mureve të disa banesave dhe disa magaza mesa kam informacion nga projekti. Është një rrugë e cila duhet zgjeruar, është në plan rregullues, është një rrugë e cila ndihmon të gjithë lagjen sipër Manazderes për të aksesuar në qytet

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Kryetar është kontaktuar me familjet të cilët do të shpronësohen ose do preken nga ky shpronësim? Keni bër konsultim publik?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Aty janë standartet, konsultim bëhet kur bëhet plani zhvillues I qytetit dmth një fazë shumë përpara. Tani ne po zbatojmë planin rregullues të qytetit, do e bëjmë me dy segmente me dy lote, nuk do ketë prishje mesa di unë , banorë që dalin jashtë shpiave të tyre, pra nuk do ketë njerëz të cilët do dalin të pastrehë si shkak I ndërtimit të rrugës por muret apo avllitë I prish të cilat kthehen në gjendjen e mëparshme aty ku e kanë pjesën. Ka disa të tjera psh tek 5 Maji sipër që është edhe një shesh I cili diskutohet, aty ka në mes të rrugës ka patur kthim kompesim pronash që është shesh pra momentalisht është rrugë, nuk e gëzon as pronari por edhe ne për efekt tonin duhet ta fusim që ta kthejmë në sipërfaqe publike, pra janë disa kategori te kto shpronësimet

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Por të pastrehët dalin nga kjo shpronësi, kjo është e rëndësishme

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Të pastrehët nuk dalin nga shpronësimi

Këshilli Bashkiak me 41 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10. Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruktion i rrugës ekzistuese "Xhaferr Belegu", ndodhur në Z.K 8527 nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi

Këshilli Bashkiak me 41 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 11 e rendit të ditës

11. Për miratimin e listës së kullotave dhe livadheve që mund të jepen në përdorim për kullotje, kositje bari dhe ndërtime të përkohshme (Për sezonin 2025)

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Mund të na sqaroni për këtë?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Është një procedurë që ne e bëjmë çdo vit për kullotat e bagëtive ose për subjektet e interesuara në fakt ne e kemi detyrim ligjor që kullotat që kemi në dispozicion që janë kryesisht fond pyjor të vendosen në dispozicion të personave që janë të interesuar për blegtori, për marrjen e luleve aromatike apo bimëve medicinale. Zakonisht ka patur shumë pak të interesuar vitet e kaluara por është një procedurë që duhet ta bëjmë sepse duhet të jemi gati për sezonin I cili vjen të kullotjes së bagëtive në zonat rurale. Është një listë shumë e madhe, duhet ti keni mbrapa të materialit, që ne të gjitha zonat ku ka potencial për tu zhvilluar blegtoria sidomos ajo gjatë periudhës së verimit që shkojnë në zonat malore janë ambjente të percaktuara të cilat lejohen dhe lejohen vende të caktuara edhe për stanet, stane të përkohshme përse kohë janë aty. I gjithë qëllimi është për bletarinë edhe nëqoftëse kërkohen për procedura për marrjen e bimëve medicinale edhe ktu është e njëjta gjë.

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Do pyesja ka interes apo jo por ti e the vet që ska patur vitet e fundit. Kjo është dhe gjë e mirë dhe gjë e keqe. Gjë e mirë sepse të paktën po konservohen ato prona

ashtu siç janë po shkatërrohen por është gjë e keqe mos interesimi I njerëzve për të marrë këto asete që ka Bashkia Elbasanit për të shtuar blegtorinë edhe kullotat. Mos interesimi I njerëzve tregon një situatë negative të shoqërisë që askush nuk do që ne si Këshill Bashkiak dhe si Bashki. Bashkia nuk mund të rrijë ta japi thjesht si ofertë që e ka në dispozicion por duhet të ketë edhe një plan nese duhet edhe një fond I caktuar që të stimulohen njerëzit sepse shikojmë që dita ditës ka rënie të popullatës nëpër fshatra, ka rënie të kokës së bagëtive të imta dhe gjedhëve dhe po hasemi ditë për ditë me mungesën e mishit I cili po vjen kryesisht I importuar nga jashtë, që po vjen edhe me atë paketën në ofertë më salmonelë brenda kshuqë kjo nuk më duket gjë normale që nëse Bashkia ka diçka në dorë ose nëse nuk e ka në dorë ti bëjmë një kërkesë qeverisë që të ketë disa stimuj subvecione që njerëzit të jenë të interesuar në zhvillimin e blegtorisë dhe bimëve medicinale. Në ntyrën që ne kemi për bimë medicinale ne jemi ndër vendet që kemi më së shumti dhe ofrojmë goxha larmishmëri kështu që nëse ka në dore diçka bashkia unë ju sugjeroj ta shikoni dhe të merrini si inisiativë për dhënien e një subvencioni aq sat ë ketë mundësi Bashkia ose ti bëjmë një kërkesë qeverisë për një plan kombëtar

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

E ka bërë mesa di unë qeveria, është bërë për tufat, kur merr bagëtitë merr një sasi parash të caktuara. Ne si Bashki jemi jashtë kompetencave për të mbështetur kto, ne këtë kemi, këtë që kemi këtë po e bëjmë

Këshilli Bashkiak me 41 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12 e rendit të ditës

12. Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për vitet 2025-2030

Taulant Sinanaj-Përfaqësues I Administratës

Rregullorja dhe plani për administrimin e mbetjeve janë detyrime ligjore që ne duhet ti miratojmë në Këshill. Ashtu siç e kemi relatuar edhe në komision rregullorja e administrimit të mbetjeve përcakton disa kritere dhe metoda për administrimin për gjithë shërbimin mbledhje depozitim dhe detyrimet që kanë subjektet individë dhe qytetarët për të formuar një system mbledhje dhe depozitimi sa më korrekt me ligjin. Në rregullore po ta shifni ajo është me shumë faqe po për ta përmbledh me disa pika më të shkurtra janë ca detyrime që janë edhe për subjektin edhe për individin për subjektet ka një periudhë gjatë periudhës së verës subjektet njëherë janë të detyruar të bëjnë ndarjen në burim dhe jo ti përziejnë të gjithë mbetjet në të njëjtin kontenier. Orari i depozitimit të mbetjeve gjatë periudhës së verës do të jetë mbas orës 20:00 ndërsa për periudhën e dimrit do të jetë mbas orës 18:00, kjo është për bizneset. Edhe për qytetarët do përcaktohet ndarja në burim se është dhe forma më rezultative dhe më ekonomike qoftë për ne si Bashki qoftë për të mbrojt mjedisin apo për gjithë procesin e trajtimit të mbetjeve. Kjo është për rregulloren, të detajuar I keni në material. Ndarjen në burim e kemi testuar në 5 rrugë qyteti ne kemi vënë kontenierët me ndarje problem është se nuk është respektuar as nga subjektet as nga qytetarët, më së shumti nga qytetarët sepse ke subjektet nëpërmjet inspektoriatëve kemi arritur të vejme një rregull të paktën për pjesën e kartonave dhe mbetjeve plastike por jo gjithmonë ka qenë rezultati që ne kemi dashur. Në këtë rregullore dhe në këtë plan ne synojmë që brenda 5 viteve të disiplinohet sepse kemi dhe leverdinë ekonomike sepse sasia

që ne do depozitojmë do të përgjysmohet. E kemi parashikuar edhe tek rregullorja edhe tek plani të gjithë subjektet do të paisen me kontenierë nga ana jonë dhe do të jetë e ndarë në kategori qelq plastikë letër dhe organike veç. Mbetjet do të tërhiqen me mjete të përcaktuara dhe mbetjet e riciklueshme do të trajtohen po nga Bashkia. Nëpërmjet ekonomisë qarkulluese do rikthehen në të ardhura për Bashkin dmth në kursejmë 2 herë, e para ulim sasinë e mbetjeve që depozitojmë në Landfill duke ul koston dhe e dyta kto mbetje që ne mbledhim të riciklueshme do konvertohen në para plus përfitues I drejtpërdrejtë është qytetari dhe ne të gjithë sepse është mjedisi duke bërë ndarjen në burim. E njëjta gjë do ndodhi edhe me lagjet e vjetra ku ne nuk kemi kontenierë, çdo banesë do të paiset me kontenierë të dedikuar për çdo mbetje. Kjo ishte ideja në vija të përgjithshme plus dhe do zhvillojmë dhe plane të tjera siç kemi dhe impjantin e kompostimit. Në synojmë që në 2026 ta vejmë në shërbim, edhe aty totali I mbetjeve që ne gjenerojmë si Bashki shkon diku te 39.000 ton dhe te mbetjet e kompostueshme të biodegradueshme janë 2 ton në ditë mesatarisht sot po nuk kemi një shifër të saktë në gjithë njësitë administrative dhe këto do të kompostohen. Impjantin ne mendojmë që ta bëjmë gati për 2026 dhe mbetjet e kompostueshme do kthehen në pleh e cila do iu shërbejë Agjensive Shërbimeve Publike tona për lulishtet por dhe do t'iu rikthehet qytetarëve në formën e shitjes me një çmim të arsyeshëm

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Sa është kostoja?

Taulant Sinanaj-Përfaqësues I Administratës

Ne kemi dy variante, kostoja nuk është shumë e lartë sepse ne kemi apliku dhe paisja do na vijë nga Gizi kurse impjanti që do të ndërtohet nuk është një impjant kush e di se ca është por është thjesht një magazinë, duhen respektu kriteret mjedisore, me betone me kullesat e ujrave etj etj. Kostoja do të jetë më shumë puntori sepse ndotje mjedisore është zero.

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Vendodhja?

Taulant Sinanaj-Përfaqësues I Administratës

Jemi duke shqyrtu 3 variante që mos jetë shumë distancë nga qyteti dhe të jetë sa më afër flasim për zonën Zallishtë të Shkumbinit por mund të gjejmë edhe një pronë ktu afër qytetit që janë po pronat tona të Bashkisë.Nuk bahet fjalë për impjant si puna e Landfillit,është tjetër gjë kjo.

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

A janë bërë analizat e kostos në kohë?

Taulant Sinanaj-Përfaqësues I Administratës

Nuk shkon më shumë se 10 milion lekë të reja.Një projekt I ngjashëm është implementuar në Cerrik dhe në Belsh.Do implementojmë të njëjtin projekt që ka Cerriku dhe Belshi thjesht do ti rrisim sipërfaqen sepse ato janë bashki më të vogla se ne.Janë imjante që ka instalu Gizi dhe Bashkimi European jo ne,nuk është se po hyjmë në terren të panjohur.

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Shpresoj të na vijnë materialet dhe rezultatet

Taulant Sinanaj-Përfaqësues I Administratës

Ato janë paisje,grirëse më shumë,traktorë dhe mjete transporti

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Nuk e di a është vetëm për mu po kto materialet nuk I kam fare.Dosjen unë e mora te mbledhja e komisioneve dhe për kto pikat ktu janë nja dy materiale që janë vetëm tituj.Thuhet që kemi hyrje kemi parathënie ktë temë e atë temë por skemi gjë fare ne në dosje.E dëgjova me vëmendje por vetëm e dëgjova sepse në letër skam gjë

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ktë material e keni të dërguar në email sepse materiali është si libër dhe ka shumë faqe

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

E ka lexu Luti, jam me Lutin

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Për këtë çështje po I drejtoj pyetje Z.Kryetar.A është parashikuar në planin buxhetor afatmesëm ky investim?Kjo kontratë?Nëqoftëse miratohet kjo kontratë për depozitim dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta do një...Do kërkojë investim mbrapa?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Do kërkojë investim mbrapa patjetër

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Pra është parashikuar apo do rishqyrtohet prapë plani afatmesëm për të gjetur...sepse ky është një plan,plani nesër do kthehet në nismë në zbatim dhe do të dojë një buxhet pra buxheti është parashikuar në planin afatmesëm të të ardhurave të Bashkisë Elbasan,përdorimit të të ardhurave të Bashkisë Elbasan?Kur ju keni bër një plan afatmesëm e keni bër nga viti 2024 deri në 2026 minimalisht

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Flasim për 2028-2030.Deri në 2030 ne nuk kemi plane afatmesme.Do ta bëjmë deri në 2030.Plani I mbetjeve 2025-2030 është plani rregullator pra përcaktojmë planin rregullator mënyrën si do bëhet ndarja në burim,si do ndahen veç mbetjet e gjetheve pemëve degët

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Unë e kuptoj por për tu implementuar ky plan në të ardhmen sepse po preupozojmë se ky është në të mirën e të gjithëve ta miratojmë kontratën mua nuk më duhet por do këtë një buxhet në 2025?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Patjetër do kërkoj buxhet

Valbona Balliu-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Pra do kërkoj buxhet I cili nuk është parashikuar në buxhetin e 2025 që na paraqitet.Do kërkoj një shtesë buxheti besoj?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Janë bër parashikimet sipas ksaj që kemi sot pra 2020-2025 është marrë një standart dhe I vendosim të njëjtat shifra,në momentin që përmirsohet infrastruktura bëhet 100% pasi ajo ka qen 80% dhe kërkon buxhet

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Unë skam marrë përgjigje se unë isha edhe tek konsulta publike që bëhet te Bashkia edhe...e parë kshu si plan dukesh I bukur por kisha disa pyetje.Ky plan që parashikon Bashkia nëse bëhet një plan I mirë studjuar në bazë të ekspertëve,nuk e di ça ekspertësh keni I keni të Bashkisë apo do kontraktoni ndonjë firmë private që ta bëj dhe Bashkia a I ka burimet njerëzore dhe ekspertët në qytet apo brenda Bashkisë që marrin vesh nga ky plan I diferencimit të mbetjeve?Sepse nuk është gjë e lehtë,janë shtete më të zhvilluar se ne si Italia dhe ato tani e kanë filluar ndarjen në burim në shtëpitë e tyre dhe po hasnin goxha vështirësi sepse kishin ca kriteret që shumë strikte dhe shumë të vështira për qytetarët kshuqë nuk është një proces I lehtë.A I kemi ne burimet njerëzore të cilët na bëjnë një plan të mirëstudjuar dhe pastaj të shofim implementimin?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Ne mendojmë që ky plani që është bër,është bër plan I mirë I konsultuar prandaj ka ardhur ktu për tu miratuar,njerëzit tonë e kanë bër,njerëzit e administratës me ekspertizë me programe të ndryshme që jan bër,që kan punuar vet,ato e kanë bër këtë.Është një produkt I Bashkisë,I stafit tonë.

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Për ktë tham pra se produktet tona po shikohen dita ditës si janë.Produktet Shqiptare në ktë fushë janë dështim total qoftë edhe kur ka qenë fusha mbetje në kohën tonë,që ka qenë vend grumbullimi.Ne kemi eksperiencë të hidhura në menaxhimin e mbetjeve prandaj po insistoje te kjo pikë.Unë si këshilltar do bëj propozime sepse atë dite kur po konsultoheshim I gjithë fokusi I Bashkisë dhe I disa shoqatave të tjera e çonin gjithë problematikën tek njerëzit.Te projekti pilot që keni pas fajin ja vendosnin njerëzve,ne kemi vendosur kosha të ndarë por njerëzit I çojnë prap grumbull,nuk I çojnë të ndarë.Nuk është faji I qytetarve.Kur të jemi në fazën e realizimit ty të duhet një ndërgjegjshim I qytetarve njëherë,që ta dijnë çdo të thotë të ndash mbetjet në burim pastaj jo të gjithë qytetarët e kanë mundësinë financiare ti blejnë ato koshat që ti kenë te shpia që duan 4-5 qese për çdo material

që ato ta ndajnë pastaj vijmë tek faza që ata do ti hedhin tek koshat,ju e dini që koshat dëmtohen.Në çdo vend që ti vendosni ato 4-5 kosha nuk keni vend të mirëpërcaktuar njëherë,shohim kosha kontenierë që janë në mes të rrugës,që njerëzit me inisiativën e tyre ja çojnë para derës tjetrit.Ka shumë hapa që ne duhet ti rregullojmë pastaj vjen tek mjetet të cilat do përdoren.Kompania e cila do marri përsipër ta menaxhojë këtë,që duhet të ketë makinë apostafat

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Kjo është pjesë e zbatimit,po flasim për rregulloren

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Mos na kthehet në boomerang siç na u kthye iceneratori se dhe iceneratori atëherë për diçka të mirë filloi.Nuk ve në dyshim qëllimin tuaj të mirë për të zgjidh problemin.problemi është kur implementohet,se do ta kemi dhe pikëm e kontratës mbrapa,so të gjendemi përpara faktit që kemi 2 vjet që përplasemi për iceneratorin

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Tek rregullorja ka ndonjë gjë që duhet ta ndryshojmë?

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Jo tek rregullorja unë ju sygjeroj vetëm këtë,te kjo rregullore nëse shikoni që nuk keni ekspertët e duhur thjesht keni marrë copy paste në rregullore dhe e keni përkthyer në shqip siç ndodh rëndom në Shqipëri,me pak fjalë bëjeni në bazë të ekspertëve.Cdo gjë që implementohet në vendin tonë duhet sipas popullit që jemi,edhe demokracia këtu nuk është njësoj si në Itali,dhe menaxhimi I mbetjeve ju mund të keni një plan të mirë mund ta keni marrë nga Italia nga Gjermania a diku tjetër por duhet ta implementoni te populli Shqiptar dhe ne tek populli Elbasanit duhet të dimë kulturën që ato kanë,duhet të dimë mundësitë financiare që ato kanë,kompanitë eksperiencën që kanë.Zotëria sapo tha që ishte I paqartë për vendin,skeni përcaktu vendin ku do bëhet kompostimi,Akoma mendoni që është turp ta vendosni pranë lumit Shkumbin.Lumi Shkumbin në vend të jetë një zonë atraktive dy anët e lumit Shkumbin,siç e ka gjithë bota në qytetet e qytetëruara europiane,neve kemi depozitu mbetje dhe mendojmë prap kompostimin ta çojmë pranë shtratit të lumit Shkumbin.Një ekspert shumë I mirë I Elbasanit që unë jam konsultuar për këtë ka thënë që ai iceneratori që keni atje afekton 500 mijë banorë të

këtij vendi,nga ujrat nëntokësorë që filtrojmë dhe shkojnë në lumin Shkumbin dhe pastaj derdhen në det dhe merren për vaditje prandaj e shoh si shqetësim.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Për pytjen që bëre të flasi sektori?

Albert Hajrulla-Përfaqësues I Administratës

Ky material sigurisht ka patur ekspertizën më të mirë të mundshme nga Uri,Bashki të forta,nga ekspertët më të mirë që ka Elbasani Ahmet Mehmeti dhe Shpresa Banja kështu që ka patur ekspertize,është diskutuar gjatë e gjerë dhe është një material që I trajton të gjitha problematikat që ka Elbasani.Mesa shikoj juve nuk keni lexuar materialin,që flisni për iceneratorin e për të tjera.Bashkia e Elbasanit I ka të gjitha kapacitetet financiare për ta implementuar këtë

Doris Madhi-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Në shpiat e qytetarëve do japim eksperiencën e Italianëve por atje është me pagesë dhe njerëzit kanë pamundësi financiare për ta përballuar

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Z.Berti përgjigja juaj duhej të ishte lidhur me ekspertët ,ekspertizën kush e ka bërë dhe kaq

Albert Hajrulla-Përfaqësues I Administratës

Bashki të forta,Uri,Ahmet Mehmeti,Shpresa Banja kanë qenë pjesë të këtij dokumenti.

Pika 12 e rendit të ditës

12.Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për vitet 2025-2030

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, - kundër, 11 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana,V.Balliu,D.Madhi,E.Muzhaqi,E.Isai,Z.Muzhaqi,R.Mita,A.Mecja,B.Copja,
M.Kaculi,Y.Balliu)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12.1 e rendit të ditës

12.1 Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve për vitet 2025-2030

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, - kundër, 11 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana, V.Balliu, D.Madhi, E.Muzhaqi, E.Isai, Z.Muzhaqi, R.Mita, A.Mecja, B.Copja, M.Kaculi, Y.Balliu)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 13 e rendit të ditës

13.Mbi miratimin e kontratës së Shërbimit publik për pranimin,depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane të ngurta,të Bashkisë Elbasan me Shoqërinë Eco-Elb sh.a

Altin Mecja-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

E para kjo sqenka online,po më thonë që sështë live mbledhja,paskemi këndu kot der tani ne

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Është kontrata e cila lidhet nga Bashkia Elbasanit për trajtimin e mbetjeve me Eco-Elbin që është ndërmarrja për trajtimin e mbetjeve e cila ka marrë impjantin e trajtimeve të mbetjeve të qarkut të Elbasanit me qera.Është përcaktuar vlera e cila ka patur një diskutim të gjatë në fakt për koston sepse nuk ka qenë diçka e lehtë për tu nxjerrë mesatarja e përpunimit.Kemi arritur në konkluzionin si Këshill administrimi I Eco-Elbit që të marrim ekspertë të jashtëm për të nxjerrë koston. Kemi dalë me dy kosto,kostoja e parë është për Landfillimin pra vetëm për landfillimin kur të paktën në këtë moment që punon pa incenerim dhe është me kapacitet të ulët të stafit,ka dalë një kosto e cila është 2600 lekë të reja për ton për trajtimin e saj dhe ka dalë një kosto nga e cila në fakt ne e kemi kërkuar që të rishihet dhe njëherë pjesa e inceneratorit pasi janë marrë të dhëna të tjera.Ne fakt ne sot do të miratojmë kontratën për pjesën me Landfill pra e kemi bërë kontratën me Landfill,me trajtim të mbetjeve me Landfill dhe në momentin që fillon punë inceneratori mbas remontit të miratojmë edhe pjesën tjetër për miratimin me incenerim të kontratës të trajtimit të mbetjeve

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Përsëritet të nderuar kolegë Këshilltarë. Sot jemi dëshmitarë të një tjetër tentative për të manipuluar opinionin publik dhe për të shmangur përgjegjësinë ligjore për një nga aferat më të rënda publike në inceneratorin e Elbasanit. Ajo që sot po paraqisni si analizë kostoje për modifikimin e kontratës duke hequr nga objekti procesit të incenerimit besoj që është një farsë, një përpjekje për të larë duart pas tre vitesh shkelje ligjore. Do thoja që tani që çështja ndodhet në prokurori dhe media e ka bërë skandalin public ju më në fund po pranoni që inceneratori nuk ka funksionuar pra po e konfirmoni vetë atë që opozita ka denancuar.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Nuk funksionon tani.

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Më lër ta mbaroj unë fjalën se ju dëgjuam pastaj mund të bëni replikën, është mendimi im si Këshilltarë.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Sdo të lejoj të thuash fjalë të pavërteta, mund të thuash është mendimi im që nuk ka funksionuar

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Ju mund të thoni të vërtetën tuaj por e vërteta është gjë tjetër dhe po e konfirmoni që ky incenerator nuk ka funksionuar.

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Jo pra nuk po e konfirmon asnjë,

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Incenerimi nuk është bërë në asnjë nga këto vite. Nëse kjo është gabim ka organe të tjera që do ta verifikojnë deri në fund nëse kjo është gabim ose jo

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

E ke gabim, mos gënje, ta verifikojnë patjetër po thuaj të vërtetën ti lëri organet e tjera

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Zoti kryetar të lutem nuk ju ndërpreva. I them këshilltarëve të mos bëhen pjesë e kësaj farse dhe të mos njollosin veten me një votë, që mbrojnë një skemë dështimi dhe për të dëmtuar të gjithë ne dhe kto qytetarë që na kanë zgjedhur. Do thoja që duhet të presim më mirë përfundimin e organeve ligjzbatuese, të marrin vendimet e tyre se çfarë është në shkelje dhe çfarë jo dhe më pas ti hapet një zgjidhje reale dhe ligjore. Faleminderit!

Ilirjan Sadiku-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Po si do bëjmë ne deri atëherë?

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Ilir po ja le përgjigjen kryetarit unë njëherë pastaj

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Skam përgjigje unë, çfarë përgjigje, ftesë të votosh ftesë të mos votosh, të mos votosh edhe ti lemë plehrat pa tërheq.

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Pytja është përse nuk e keni në ekspertizën tuaj?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Nuk po miraton ekspertizën ti po miraton kontratën, formatin e kontratës. Ti nuk je për të miratu ekspertizën, as ti as Keshilli Bashkiak

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Ske analizë kostoje

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Është bërë disa herë analiza e Kostos

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Na keni sjelle një analizë kostoje, po pra përse nuk e keni të përfshirë ekspertizën pjesën e mbetur të riciklueshme, ankandet? Keni bërë analizë kostoje, ku e keni ankandin e mbetjeve të riciklueshme e cila nuk ka ndodhur për 3 vite me rradhë, e

verifikuar me të dhënat dhe përgjigjet zyrtare nga Eco-Elbi,tani më thoni ju pse nuk është

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Ja se do të përgjigjet Eco-Elbi

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Jo jo e dini ju përgjigjen në rradhë të parë se ka perqindje të aksioneve bashkia Elbasan pastaj Eco-Elbi

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Të përgjigjet Eco-Elbi për çështje teknike

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Mund të bëje një ndërhyrje përpara se të flaës Eco-Elbi.Është e njëjta gjë,besoj është në të njëjtën llogjikë.Kryetari dhe sekretari I Keshillit Bashkiak në mbledhjen e komisioneve bëra një kërkesë që e mbajtët shënim dhe duhet tia keni transmetu drejtimit të Eco-Elbit për një material që mu tregua vetëm vizualisht pra në letër nuk e mora asnjëherë në email siç e kërkoja:Tre vitet e fundit të detajimit të kostove që nuk ma dhatë.Kjo është teknike si ndërhyrje teknike por që nuk e kam edhe pse e kam kërkuar kurse parimisht pavarsisht se cfarë do referojë drejtori I Eco-Elbit vazhdoj ti qendroj qëndrimit tim politik si herën e fundit që kam fol për këtë temë në Këshillin Bashkiak,unë mendoj dhe kërkoj që Bashkia Elbasan duhet vetëm të marrë në konsideratë largimin e depozitimit të plehrave nga ai vend.Asnjë lloj rinovimi dhe vazhdimi në situatën aktuale.Pavarsisht se çfarë kostoje mund të ketë financiare,nuk besoj që është kurrë më e madhe se kostoja me të cilën përballen qytetarët,jo vetëm qytetet e Elbasanit por dhe më gjerë ,koston ekologjike,të sëmundjes,korupsioni që është bërë etj etj po ajo është çështje që e tejkalon Këshillin pastaj,është çështje e prokurorisë.Pra ne duhet flasim vetëm për heqjen e depozitimit të plehrave nga ai vend e më pas edhe për gjërat që nuk janë bërë,incenerimin,koston etj etj.Ky është qëndrimi im politik edhe ktij I qendroj edhe nuk miratoj asnjë lloj gjëje tjetër se është e kotë për mua,është harxhim kohe dhe harxhim shëndeti dhe harxhim parash për gjithë qytetarët edhe për Bashkinë.Vetëm nëqoftëse e keni me korrupsion që dilni me fitim po kjo është vetëm harxhim

Leli Kaja-Përfaqësues I Administratës

Përshëndetje të gjithëve. Ne si Eco-Elb jemi përpjekur ta bëjmë punën sa më mirë pavarësisht llaveve që mund të vijnë se ne jemi mësuar të ecim me hipoteza edhe këtu shumë mirë e dënon me opinion po kjo nuk ka rëndësi, janë organet ligjzbatuese ato që do ta shikojnë dhe do ta vendosin atë, ne nuk kemi pse bëjmë hetuesin kur sjemi hetuesia flasim për atë që na takon. E para ne nuk mund të bëjmë mbledhje të plastiës apo diçkaje tjetër kur inceneratori është i fikur, e kemi me ligj të ndaluar zonjë që thoni që kemi 3 vjet që e kemi marrë dhe e kemi shitur, kjo është gënjeshtër. Ne kemi mbledhje plastike rreth 16 ton të deklaruar dhe në prokurime me letër për periudhën që ka punuar inceneratori për 7 muaj dhe të tjerat pastaj janë llafë pazari kështu që më mirë të jemi korrekt mos ecim me llafë pazari. Kjo është pjesa kryesore, pjesa tjetër pastaj ju mund të thoni çka të doni jeni të lirë, ne s'na bënë përshtypje kjo pjesë jemi mësuar që të ecim me opinione. Në lidhje me problematikat që kemi janë situata shumë të vështira ekonomike që ne po kalojmë për arsye se çmimi ka qenë shumë i ulët që në fillim. Gjatë viteve të akumuluar çmimet janë rritur dhe ne kërkojmë një rritje të çmimit për ta mbajtur të ndezur në kohën që do bëhet dhe remonti. Aktualisht prona është e bllokuar akoma, që me bllokim gjykatë, tani e ka agjensia e bllokimit të pasurive dhe kjo ka bërë që nga ana e shtetit të jetë i pamundur investimi në ato që ne kemi kërkuar në 4 apo 5 milion euro për ta vendosur në ndezje inceneratorin. Ka pas probleme të theksuara që ne disa dhe ju kemi dhënë me shkrim por nuk ju kemi dhënë me shkrim që 3 vjet kemi bërë mbledhje dhe i kemi shitur ato plastikën kështu që kjo është e kotë. Kjo është situata, ne kërkojmë që ta kalojmë sot, kjo pjesë që është vetëm grumbullimi i mbetjeve dhe menaxhimi i tyre. Kur të ndizet inceneratori do të jetë faza tjetër që do flasim prapë edhe do vendosni mbi të gjitha se çfarë do bëhet. Këtë pjesë kisha për të sqaruar pastaj të tjerat skanë ndonjë problem. Ka qenë 25.000 lek pa tvsh tani bëhet 26.000 lek. Rritet dhe është pa marzh fitimi se po të llogaritesh që ne kemi nevojë edhe për marzh fitimi se inceneratori jep edhe defekte dhe detyruesisht ato duhen bërë, dhe në momentin që do japi defektin ne prapë do presim apo mund ta fikim dhe kur të na mbushet mendja pastaj ndonjërit që ta kalojë ne do presim prapë në hije, se ne dhe situatën aktuale që po e kalojmë me 26.000 lek e kemi pa marzh fitimi me shpresën që mos prishet dhe që të vazhdoj mirë kur të ndizet. Inceneratori ka punuar 7 muaj dhe ju e dini mirë se për këtë ka dokumenta dhe mbajnë përgjegjësi të gjithë njerëzit që kanë firmosur, që kanë marrë edhe

organet kompetente.Ka punuar 7 muaj në vitin 2023 dhe rreth 1 muaj në vitin 2022.Ka pas probleme me prodhimin e energjisë elektrike,po kjo ka qenë ekzistuese dhe jemi të detyruar të paguajmë energji elektrike por janë disa gjëra që janë fakte dhe ne I kemi çuar me shkresa organeve kompetente dhe ministrive përkatëse kështu që nuk është se ne kemi fshehur diçka se kemi pas ne interes.Mirë është që ne të gjejmë një zgjidhje për qytetin e Elbasanit,Të bëjmë një shtesë Landfilli pasi është në fazë të vështirë,landfilli aktualisht është I tejmbushur edhe të jet mirë për qytetin,të paktën të pastrojmë mushkëritë.Pataj sherret personale akuzat I vazhdojmë se këtu jemi ska problem.

Bianka Copja-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Nuk po flasim këtu për pjesë personale po flasim për të mirën e qytetarve të Elbasanit sepse këtu Brenda nuk jemi asgja ma tepër se përfaqësues të tyre dhe të zgjedhurit e tyre.Ju e dini shumë mirë që dhe në përgjigjen tuaj e keni dhënë që për 3 vite nuk është kryer asnjë ankand dhe I bie që kto mbetjet e riciklueshme...janë brenda në incinerator?jo jo ju po thoni janë brenda ok atëherë organet kompetente do I verifikojnë që kto mbetje janë aty brenda me kaq ton sa ju po thoni.Më fal e keni problem?Zotëria ktheu përgjigje dhe unë po I kthej përgjigjen që më takon.Është e drejta ime që të kthej përgjigje,ju nuk donit të përgjigjeshit

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zonja Bianka ti po thua që unë nuk jam dakort me atë që po thua ti

Bianka Copja-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Jo unë I bazohem shkresës zyrtare që më ka ardhur në emrin tim,përgjigjes time

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ti të paktën je nga personat që je në dijeni dhe ti po I thu tani që nuk është ashtu

Bianka Copja-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Po sepse përgjigja konstaton këtë gjë.Edhe nëse është gabim ose jo e drejtë por koha më ka dhënë të drejtë që për 3 vite ky incenerator ka harxhuar fonde publike dhe po nav ret të gjithëve atje.Jo vetëm mua por të gjithëve ne,fëmijve tanë që kemi vendosur të jetojmë në këtë qytet.

Altin Meçja-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Një pyetje kisha unë,ktë vit zgjedhor qenkan rrit dhe mbetjet siç duket në ktë vit zgjedhor edhe plehrat paskan votu dmth

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Drejtorit I bëni letër me shkrim.Materialet I keni aty ça keni probleme shqetsime mund ti diskutosh

Bianka Copja-Anëtare e Keshillit Bashkiak Elbasan

Janë 4 kërkesa të miat që janë të protokolluara dhe ka 4 muaj që nuk vjen përgjigja atere ku qendron problemi,mund të pyesni tek personat përgjegjës në Bashki dhe do ju thojnë që përgjigja nuk ka ardhur ,ka më tepër se 4 muaj dhe nuk kemi asnjë informacion,nuk e di po është bër një shmangie totale

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Tek jo pikë sipas informacionit të sjellë me email analiza e Kostos që është bër nga kjo firmë kjo vetshprehet ktu që analizën e Kostos nuk e ka bër në situatën reale që është,grumbull që duke ndjekur procesin realisht sesi ndodh dhe sa janë kostot reale thjesht kam marrë pasqyrat financiare qe Bashkia I ka paraqit dhe kjo thjesht në zyrë kanë bër ca kalkulime.Eco-Elbi I ka paraqit pasqyrat financiare dhe kjo I ka bër përlllogaritjet pastaj.Kjo nuk është përlllogaritje e saktë.Përlllogaritja e saktë është kur ti del në terren dhe e shikon jo thjesht kalkulime në zyrë me letra që çon Eco-Elbi.Eco-Elbi çon pasqyrat financiare të vetat,kjo zonja audituese ka marrë pasqyrat financiare dhe kshuqë nuk është reale kjo kosto,mund të jetë shumë e ulët ose tmerrësisht e lartë.Për ta përmirësuar,pse duhet kjo analizë?Që të shpëtojmë nga kjo situatë ku jemi ,nuk e keni bër kot ktë.Nëse e keni bër thjesht për të shpëtuar nga ndekja që po bën prokuroria thjesht të na hidhni hi syve neve dhe prokurorisë që me incenerator ndezur ishte kostoja 50.000 leke,me incenerator fikur është kostoja 25.000 leke por duhet të rritet 1.000 leke sepse duhet të bëhet 26.000 leke.Po tregoheni edhe zemërgjerë që nuk po e rrisni më shumë pork jo është thjesht një artificë që ju bëni thjesht për të justifikuar kontratat e mëparshme të cilat në mënyrë abuzive me një kosto prej 25 euro ju nuk keni bër asgjë thjesht keni rritur malin e mbetjeve,dhe ai nuk është as landfillim por po jua them sepse jam konsultuar me ekspertë,nuk ka landfillim në atë lloj menyre që është ngritur si mal.Landfillimi është ndryshe..hidhen shtresa ka shumë nuk po I hyj detajeve ,ai është thjesht një vend grumbullim mbetjesh dhe kjo kontratë e re do vazhdojë po të

njejtin avaz.Thjesht ju keni fur në korniza ligjore punën e Kostos,kostoja shumë e lartë për të justifiku edhe inceneratorin që nuk punon.I keni fut një term aty pa incenerim edhe kontrata tani quhet e rregullt.Kjo kontratë vazhdon të jetë abuzive dhe korruptive dhe po merr jetë njerëzish.Juve nëse ju duket,po I drejtohem gjithë këshilltarëve të majtë e të djathtë pa parti,po merr jetë njerëzish përditë,po fut në trupat e qytetarëve të këtij qyteti sipas një eksperti që afekton 500.000 banorë të këtij shteti.Lumi Shkumbin I cili po ndotet nga ujrat nëntoksorë dhe ju as se vrisni mendjen as për spostimin e vendit.Kontratën do ta votojmë kundër dihet ajo por duhet të spostoni urgjent vendodhjen e grumbullimit të mbetjeve që nuk është as landfill,merrni po deshët ekspertin më të mirë edhe të partisë Socialiste vetëm të jetë I ndershëm e do ju thojë që nuk është landfillim është grumbullim

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ju përshëndes të gjithëve.Kryetar e dini shumë mirë që kjo është një pikë jo e nxehtë por do thoja shumë domethënëse pika e vendgrumbullimit të plehrave.Po e le mënjane çështjen korruptive.Do kisha shumë dëshirë kryetar tju bëja një thirrje si mik.Përveç faktit që kjo kontratë duhet të jetë sepse duhet dikush të funksionojë atje...të lutem sa më shpejt të jepni një zgjidhje për këtë çështje.E kemi biseduar disa herë por nuk na ka dëgjuar njeri.E kemi thënë para 4 muajsh këtu,kemi qenë gati të gjithë,që të bëjmë presion që të paktën minimalisht bëjmë një landfill të ri.Landfill të ri jo një mal tjetër të ri.As nuk e votuat,sajuat një budallalluk aty jo 3 lek këtu jo 2 lek atje,e shtyt 4 muaj prapë.Jemi të gjithë me bon sens sepse po e vuajmë të gjithë,fëmijët e tuaj fëmijët e mi apo jo?Ai mali atje nuk është landfill ai,sëshhtë as me letra as pa letra sepse ai ka 2 vjet ka hyp nga leja me dhjetra mij ton.Po ta them dhe njëherë sepse je kryetari I Bashkisë,je dikushi.Miqësisht kjo gjë duhet zgjidhur ose vit mbas viti 7 milion ktu,6 milion atje dhe hajde o burra..nuk ka zgjidhje.Kjo gjë duhet zgjidhur dhe ta thashë që hapi I parë ram dakort të gjithë të jemi ti bëjmë presion të gjitha instancave ktu duhet një landfill I ri urgjentisht ose dilni dhe thoni ju një ditë...jepni zgjidhjen më të mirë.Neve me aq sa jemi konsultu kjo na del përpara syve.Unë këtë thirrje kisha,e kisha me shumë bon sens

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëhere bëhuni një grup 3-4 veta,sajoeni atë kërkesën nuk ka anjë gjë të keqe dhe e diskutojmë në mbledhjen e Këshillit.Ne në parim kemi rënë 2-3 herë dakort dhe asnjëri se ka marrë inisiativën që të thotë duhet një landfill I ri.Kush është pro?

Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Tek pika 3 të dhënat financiare ekzistuese është një paradoks I madh që ju lutem sepse ne kemi dhe financiarë,gjithashtu dhe Eco-Elbi ka financier të tjerë dhe Bashkia gjithashtu.Shpenzim energjie elektrike është më e lartë gjatë vitit 2024 kur ska punuar inceneratori asnjë ditë sesa në 31.12.2022 kur ka punuar 7 muaj.Tani,kur inceneratori punon besoj që të gjithë e dimë që lënda e parë se nuk ndodh vetëm tek energjia elektrike,se këtë ta kap çdo prokuror në botë se më I paafti të jetë,pra kto shifra rishihini njëherë mirë.Unë nuk e di sesi I kan çuar sepse lënda e parë,ke më shumë përdorim të lëndës së parë kur ska punuar inceneratori sesa kur të ka punuar inceneratori.Gjithashtu shpenzimet e energjisë elektrike sepse ti e ke zero koston e energjisë elektrike se të ka punu turbina pra vetëm ke dhënë nuk ke marrë nga inceneratori.Ti ktu e ke më të lartë në 2024 kur e ke patur zero incenerimin sesa në vitet kur incenerimi ka punuar qoftë 7 muaj qoftë 1 muaj.Unë gjykoj që shife mirë këtë

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ok kush është pro pikës 13?Për kontratën?

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 11- kundër, 1-abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana,V.Balliu,L.Hasa,E.Muzhaqi,E.Isai,Z.Muzhaqi,R.Mita,A.Mecja,B.Copja,M.Kaculi,Y.Balliu)

(D.Madhi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 14 e rendit të ditës

14. Mbi të drejtën e shpërndarjes së botimit "Elbasani dhe lëvizja kombëtare shqiptare në vitet 1878-1912"

Altin Meçja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Se kemi pa si libër, duhet të ketë një draft, një gjë që ta lexojmë. Kush janë autorët?

Erki Koka-Përfaqësues I Administratës

Autorja e librit është Majlinda Peza, e ke të shkruajtur në relacion

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Relacion ka plus e ke dhe me email. Bëhet fjalë vetëm për ta shpërndarë

Altin Meçja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kto gjëra ti lexojmë njëherë para se ti votojmë, ska asgjë relacioni unë e kam pa se ke lexuar ti. Pro jam dhe unë po jo kaq banale

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 15 e rendit të ditës

15. Për miratimin e transferimit të aseteve nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale në Agjensin e Shërbimeve Publike Urbane

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, - kundër, 5-abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana; E.Muzhaqi; R.Mita; Y.Balliu; B.Copja)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 16 e rendit të ditës

16.Mbi miratimin e fillimit të procedurave për përditësimin dhe kalimin në pronësi të pasurive me vlerë historiko-kulturore të qytetit të Elbasanit,dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Në kuadër të projektit të rivitalizimit të kalasë dhe të gjithë nxjerrjes së pronësive në fakt që kemi patur në kala,janë disa prona që janë pronë shtet të papërcaktuara si pronësi të kujt janë.Kemi patur një korrespondencë të gjatë me ministrinë e linjës,për të gjetur nëse janë në inventaret e tyre por siç e dini inventarët janë ndarë në zona kadastrale dhe me zëra në bazë të ministrive dhe na rezulton që është pronë shtet.Në këtë moment duam që kto prona shtet mos rrijnë më pa një digaster të përcaktuar që të kujt janë por ti kalojnë qytetit si pronë e qytetit.Të fillojmë procedurat,është thjesht fillimi I procedurës,mundet që mos kaloj sepse kalojnë me vendim të Këshillit të Ministrave por qëllimi jonë dhe dëshira jonë si administratë e Bashkisë që ia kemi kaluar edhe Këshillit Bashkiak për të filluar procedurat është që kto të kalojnë në pronësi të Bashkisë Elbasanit të qytetit dhe ne të kemi pronësinë e tyre për të gjitha eventet ashtu siç kemi dëshirë të rinovojmë hamamin e grave të Elbasanit , burgun e vjetër,shtëpinë e Kostandin Kristoforidhit,për murin e Kalasë dhe vijën Egnatia.Janë disa asete që janë pronë shtet e papërcaktuar se në varësi të kujt janë.Ky është qëllimi jonë të fillojmë procedurat,ti kalojnë qytetit

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Ne e trajtuam edhe në mbledhjen e komisioneve këtë dhe do isha shumë I kënaqur që të bëheshin rregullime dhe zbulime në kala dhe projekti të reflektonte me të vërtetë historinë dhe kulturën që mbart kalaja në vetvete në rradhë të parë.E dyta

dua ta përgëzoj drejtorinë përkatëse në Bashki pra Drejtorinë E Trashëgimisë Kulturore që informacioni që ne kërkuam e solli me të vërtetë shumë shpejt dhe shumë korrekte në kontrast të thellë nga afëra korruptive vrastare e inceneratorit që vazhdon me muaj të tëra nuk sjell. Pra aty kur është për tu përgëzuar, aty ku është për të bashkëpunuar bashkëpunojmë me duar dhe me këmbë edhe I përgëzojmë dhe njëkohësisht jam shumë I interesuar sit ë gjithë këshilltarët e tjerë që në momentin e parë që do kemi projekte konkrete ti shofim sesi do të zhvillohen sepse jemi qytetarë të këtij vendi kemi gjak që trashëgojmë brez pas brezi dhe duam që të bëhet ajo kalaja, tërheqim njerëz po ta shijojmë edhe vetë. Faleminderit!

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ju përgëzoj për këtë nisim edhe për atë që do ta rivitalizoni kalanë, shpresoj ta bëni në mënyrën e duhur atë vlerë historike që ne kemi dhe me njerëz të cilët janë të aftë dhe dinë ti bëjnë këto rivitalizime siç e Meriton qyteti Elbasanit por kisha një sugjerim për Bashkinë. Tek porta e kalasë sa hyn aty djathtas janë një 3-4 kioska që I përkasin viteve 90 me ato hekurat e shpifur. Merrni ndonjë masë, nuk besoj të duhet ndonjë shumë e madhe, vendosni diçka aty ose hiqeni. vendosni një mbulesë aty me ca pamje sepse sapo hyn një turist në hyrje të kalasë direct përballet me një pamje aspak dinjitoze. Të pastën mua si qytetar ma vret syrin sapo hyj imagjino një I huaj që vjen për të parë dhe sot ne duhet të mburreshim me atë dhe jo më të ishim në fazën Akoma të zhvillimit që jemi shumë mbrapa. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëherë bashkë me sugjerimet e kolegëve kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 17 e rendit të ditës

17.Mbi miratimin e marrveshjes së projektit:Inovacioni Klimatik neutral I Elbasanit në Lëvizshmërinë (eCIM)

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Bashkia Elbasanit në fakt ka aplikuar në shumë projekte ndërkombëtare këto kohë dhe një nga projektet që kemi fituar që është një mision I madh I Bashkimit Europian.Ky është një mission në fakt që është I dyti që fiton në kuadër të këtij projekti,në bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse të cilat ato bëjnë të mundur që ne të aplikojmë për këto projekte dhe ku jemi Bashkia Elbasanit si përfituese e projektit edhe në kuadër të zhvillimit që do marri kalaja dhe një pjesë tjetër e qytetit të qendrës,të bëjmë të mundur që me anë të një studimi të kemi uljen maksimale të ndotjes Brenda zonës së kalasë,sipas një qarkullimi që do ket ajo dhe të qendrës së qytetit që është e lidhur me kalanë.Ky është një project tjetër në fakt që ka të bëjë me lëvizshmërinë dhe me uljen e ndotjes por dhe me efijencën e energjisë që ka në përgjithsi te kjo.

Anja Hodaj-Përfaqsuere e Administratës

Duke qenë se ne jemi pjesë e programit net zero cities dhe një nga 5 shtyllat kryesore për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2030 është transporti,ne aplikuar me këtë project për arritjen e draftimit përfundimtar të një plani të përgjithshëm për ecjen dhe për biçikletat qe do pilotohen në bulevardin Aqif Pasha me qëllim që duke ndërgjegjsuar komunitetin,duke pasur aksesueshmërinë më të madhe të ktyre zonave për ecje dhe për biçikletat do arrijmë edhe qëllimin tonë që të ulim emetimet e gazrave serë prej automjeteve.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak


Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 18 e rendit të ditës

18. Transferim fonde për bashkëfinancim investime në buxhetin e vitit 2025

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Keni pyetje?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Faleminderit Zoti kryetar sepse në fakt është nga fundi por duhet të ishte nga fillimi për nga rëndësia që ka kjo si pikë pasi të dyja kto janë lajme shumë të mira dhe fillimi I projektit për qarkullimin në zonën qendrore të Elbasanit por dhe financimi I 3 shkollave të reja të cilat presim ti fillojmë shumë shpejt dhe ne si Bashkia Elbasanit po akordojmë pjesën tonë të financimit për projektin e shkollës Dhaskal Todri, për projektin e shkollës Naim Frashëri dhe për projektin e shkollës së Shushicës që janë 3 projekte të cilat në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Rinisë do bëjmë të mundur rikonstruksionin e tyre dhe janë projektë të cilat njëri është bërë I detajuar njëri është bërë nga Bashkia e Elbasanit, 2 të tjerë janë bër nga projekte të cilat I kemi miratuar vjet me USAID-in dhe UNICEF-in të cilat

kanë bërë të mundur projektimin e shkollave dhe tani jemi në fazën që fillojmë implementimin e zhvillimit të tyre. Pra rikonstruksionin total të të treja shkollave. Kemi dhe dy shkolla të tjera të cilat në fakt janë momentalisht në rikonstruksion siç është shkolla Fadil Gurmani, gjithashtu edhe shkolla e Treganit e cila dhe ajo është në rikonstruksion dhe shpresojmë ashtu siç kemi ndjekur edhe punimet që sapo të fillojë viti I ri akademik të dyja shkollat do të jenë gati dhe ndërkohë do të jenë edhe 3 kantiere të tjera për 3 shkollat të cilat do të jenë shumë të rëndësishme, 2 të qytetit 1 gjimnaz dhe 1 shkollë nëntëvjeçare por edhe një shkollë në njësinë administrative Shishicë e cila është një nga shkollat më të mëdhaja që ne kemi në njësitë administrative. Gjithashtu kemi edhe 5 projekte të tjera të gatshme të cilat në të gjitha momentet aplikojmë për të kërkuar financime dhe kemi predispozicion maksimal për të filluar këto rikonstruksione. Ky akt ka të bëjë pikërisht me këtë, me ndryshimet buxhetore për rialokime të brendshme në buxhetin e Bashkisë. Faleminderit!

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 19 e rendit të ditës

19. Transferim fonde në buxhetin e vitit 2025, për ASHPR

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

I keni materialet?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Në fakt kemi disa muaj që shërbimi I pastrimit në njesitë Administrative bëhet përsëri nga Ndërmarrja e punëve publike, duke qenë se kërkon një fond specific dhe një fond I cili ishte parashikuar në buxhetin e vitit 2025 që u miratua në dhjetor 2024 specifik për pastrimin bëhet detajimi duke qenë se kemi qen në periudhë zgjedhore dhe nuk mund të bënim dot ndryshimet buxhetore, kaloi në mbledhjen e parë pas periudhës zgjedhore dhe të dyja aktet e fundit kanë të bëjnë me fondet e buxhetit për ASHPR dhe një pikë tjetër e cila është për puntorët e Shërbimeve Rurale ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve të Ndërmarrjes së Punëve Publike për të kryer pastrimin dhe heqjen e mbetjeve në zonat rurale. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Keni ndonje pyetje? Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 20 e rendit të ditës

20. Raport monitorimi buxheti 2025

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Materialet I keni patur, keni ndonjë gjë për tu shpjeguar?

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo nuk ka gjë sepse është raport monitorim edhe as për votim nuk mund të diskutohet, jo jo nuk e hedh dot në votim, është për raportim, nuk votohet

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 21 e rendit të ditës

21. Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr 141 datë 26.12.2024 vendimi nr 127 datë 26.11.2024 ,si dhe shtimin e numrit të punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo ishte ajo që sapo foli kryetari, bëhet fjalë për 11 veta besoj, kush është pro?

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Normalisht që unë e lexova dhe ngaqë I është heq asaj firmës që bënte grumbullimin e mbetjeve në disa zona rurale, tani Bashkia do ta bëjë vet atë dhe I duhen 11 puntorë për shtesë. Mua edhe aq sa ka qenë më duket shumë I lartë numri I punonjësve të cilët punojnë në Bashki 1470 sa ka qenë dhe tani do vej 1481 me 11 të shtuar. Nuk kishte Bashkia njerëz në zonat rurale të mjaftueshëm nga ato të cilët janë, të spostoheshin nga një sektor të transferoheshin? Duhet me patjetër të shtoheshin 11 të tjerë? Sepse më duket një diçka absurd. Në një qytet që po rrudhet dita ditës nga emigrimi masiv administratë vetëm rritet. Numri I popullsisë bie numri I administratës rritet. Unë këtë raport nuk e kuptoj dot, nuk e di sesi I bani ju llogaritë. Edhe një pozicion tjetër, një sekretar që është për kryetarin, që ishte dhe një pozicion tjetër që e pash aty që të shtohesh brenda kësaj pike. Pse shtoni gjithmonë organikën e punonjësve kur jemi në një popullatë në rrudhje si qytet dhe si vend? Kjo është një paradoks që unë nuk po arrij ta kuptoj as në nivelin e qeverisë po Kryeministrin nuk e pyes dot kështu që po pyes Kryetarin e Bashkisë. Pyetja është kjo pse rritet numri I punonjësve kur jemi në një popullatë në rënie?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ja ta shpjegoj unë psenë. Nuk jemi popullatë në rënie

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Në 2013 qarku I Elbasanit ka patur 400.000 banorë,ju na I keni sjellë shifrat.230.000 banorë ka vajt qarku Elbasanit

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Nëqoftëse do për materialin për komentet pastaj hajde flasim,bëjmë debat televiziv,e bëjmë për shou atq pjesën po nëqoftëse do për materialin janë rritur 11 puntorë sepse kërkohen për makinat e mbetjeve dhe për të ofruar një shërbim më të mirë të tërheqjes së mbetjeve.Prandaj kërkohen edhe puntorët sepse puntorët normalisht kërkohen edhe për të punuar me 2-3 turne,varet sesi e kan orarin e punës së tërheqjes së mbetjeve sipas grafikut që kanë dhe kjo kërkohet ktu dhe nuk mund të hiqet puntori I mirmbajtjes së rrugëve në njësitë Administrative dhe të vij në qytet të tërheqi plehrat e të rrijë pas makinës dhe ka një cikël të caktuar.Kto puntorë për aq puntorë sa ishin dashur janë më pak se çkishte kompania,janë shumë herë më pak.Kemi edhe puntorë të tjerë që janë tek pastrimi,sot me ato puntorë po e bëjnë por duhet për të rritur cilësinë dhe për të marrë mjetet e reja duhen edhe puntorët e rinj,duhen shoferë se do blejme makina.Sdo ti japi puntori që pastron kanalet makinës së mbetjeve që ka një tonazh të caktuar

Artan Kana-Anëtar i Keshillit Bashkiak Elbasan

I nderuar kryetar kjo nuk është për të bër shou.Ktu për ta bër debatin me njëri tjetrin sa më të bukur dhe më të shpjeguar,ta thashë në bazë vetëm të letrave që bëhen nëpër zyra,kto I keni në rregull ju normalisht që duhen ata 11 puntorë por mund të merreshin nga sektorë të tjerë dhe mund ti kurseheshin buxhetit të shtetit të Elbasanit 11 puntore shtesë dhe rëndohet buxheti Elbasanit.Me çfarë do ti paguash ti 11 puntorë?Shtohet zëri I shpenzimeve.Shtimi I punonjësve dhe I organikës së Bashkisë duhet të vejë paralel me cilësinë e shërbimit.Cilësia e shërbimit lë për të dëshiruar

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, 3-abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana;V.Balliu;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.05.2025, ora 14:11 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Pika 22 e rendit të ditës

22.Mbi përdorimin e fondit të Mbrojtjes Civile për vitin 2025

Ndriçim Sinani-Përfaqësues I Administratës

Herën tjetër do bëhet ndarja për investime kurse këtë rrjedhë kemi vetëm ndarjen për efekt të thesarit dy kode dmth kodi I investimeve është kod I veçantë dhe kodi I dëmshpërblimeve është kod I veçantë

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Ka ndonjë ndonjë gjë tek të ndryshmet?

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Përsa I përket rotundos, rivitalizimit të rotundos, nuk më duket ndonjë punim cilësor, po përdoren po të njëjtat pllaka që u hoqën, ato që ishin, firma që po i bën. Ndonjë tabelë që të shohim se çfarë do të bëhet aty nuk ka të paraqitme. Cdo biznes që ka ndërtu diçka të vogël I është dashur të bëjë një bander të madh ta vinin aty se të vinin ato direkt. Aty nuk ka asnjë lloj table informuese çka do bahet, mos na ngrihet ndonjë shëmtirë aty, se ajo që ishte shëmtirë ishte, shumë mirë u ba që u hoq

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit të gjithëve!

Mbledhja përfundon në orën 15:49